



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

**VENDIM**  
**Nr.34, datë 23.01.2020**

**PËR**  
**MBARIMIN E STATUSIT TË MAGJISTRATIT PËR GJYQTAREN E GJYKATËS SË**  
**RRETHIT GJYQËSOR TIRANË, ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 61 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në pikën 3, të nenit 65, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të kërkesës për heqjen dorë nga statusi i magjistratit, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistrates për znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të dorëheqjes së saj nga ky status.
2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 24.01.2020.
3. Përjashtimin e menjëhershëm të gjyqtares znj. {...}nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
4. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares znj. {...}sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**